



Pranuar / Dorezuar Priljezi/Prodato Received/Delivery	21.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6367	2022	1/6



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.770/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Ardita Hxhnikaj-Demi, dhe Jeton Koca, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr. 770/2022, të datës 06.09.2022, së ankuesit me adrese banimi

nga kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.10.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr. 770/2022, të datës 06.09.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.Prot:2347 i datës 29.08.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë i Ministrisë së Mbrojtjes.

III. ANULOHET Konkursi me Nr. Reference: RN00009334 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Psikolog” i datës 05.07.2022, i shpallur nga Ministria e Mbrojtjes dhe çdo veprim tjetër që rrjedh nga kjo procedurë.

IV. OBLIGOHET, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit që të bëjë zbatimin e vendimit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Mbrojtjes më datë 05.07.2022 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00009334 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Psikolog" ku afati për aplikim ka qenë nga data 21.07.2022 deri më datë 28.07.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe i është nënshtruar fazave të procedurës, ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka zhvilluar procedurën dhe pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit Komisioni për vlerësim brenda kategorisë, ka bërë renditje përfundimtare me të cilin kandidaten [redacted] e ka vlerësuar me gjithsejtë nëntëdhjete e dy pikë (92), ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë tetëdhjetë dy pikë (82), ndërsa më datë 24.08.2022 është publikuar njoftimi për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesi kundër këtij procesi ka parashtruar ankesë tek Komisioni për vlerësimin e lëvizjes brenda kategorisë, ndërsa ky i furnit më datë 29.08.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot:2347 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit, duke e lënë në fuqi vlerësimin e komisionit.

Ankuesi [redacted] me datë 06.09.2022, me numër të protokollit 5166/2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Psikolog“ të zhvilluar nga Ministria e Mbrojtjes, kundër Vendimit datës 29.08.2022, me numër protokollit 2347, të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa me datë 27.09.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesa A.nr. 770/2022 e të datës 06.09.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi e datës 05.07.2022; Njoftim për kandidatin fitues i datës 24.08.2022; Njoftimi përfundimtar për kandidatin fitues i datës 01.09.2022; Ankesë e datës 24.08.2022 drejtuar Komisionit i vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë; Vendim me nr. prot. 2347/2022 i datës 29.08.2022; Akt emërim për [redacted] i datës 01.08.2012; Letërnjoftimi lëshuar nga MPB; Përgjigja në kërkesë me nr.prot.5694/2022 e datës 27.09.2022; Email- Njoftim i datës 24.08.2022 nga [redacted] për [redacted] Email- Njoftim i datës 24.08.2022 nga [redacted] për [redacted] Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 23.08.2022; Formularët e Vlerësimit për Interviste me gojë për [redacted] Formularët e Vlerësimit për Intervista me gojë për [redacted] Email-Njoftim për Intervistim i datës 17.08.2022 nga [redacted]; Orari për Intervistoma i datës 23.08.2022; Lisat e aplikantëve me nr. ref RN00009334; Vendim i departamentit i politikave të personelit dhe rekrutimit i datës 12.08.2022; Njoftim për kandidatin [redacted] i datës 04.08.25022; Vendim i Departamentit i politikave të personelit dhe rekrutimit i datës 04.08.2022;

Formulari për verifikimin paraprak të kandidatëve për [redacted] e datës 01.08.2022; Formulari për verifikimin paraprak të kandidatëve për [redacted] e datës 01.08.2022; Formulari për verifikimin paraprak të kandidatëve për [redacted] e datës 01.08.2022; Vendim nr. protokolli 2099 i datës 02.08.2022; CV e [redacted] prej 1-7 faqe; Diplomë me nr. prot.425 i datës 10.06.1998; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës- Fakulteti Filozofik, nr. 66 i datës 22.09.2005; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" -Fakulteti Filozofik , nr.190 e datës 20.03.2013; Certifikatë e datës 29-30.10.2011; Certifikatë e datës 10.06.2012; Certifikatë e datës 12.10.2010; Certifikatë e datës 21.11.2013; Certifikatë e datës 28.03.2014; Certifikatë e datës 14.11.2014; Certifikatë e datës 22.04.2015; Certifikatë e datës 08-09.06.2015; Certifikatë trajnimi; Certifikatë e datës 09-12.11.2015; Diplomë e datës 23.05.2016; Diplomë e datës 07.11.2016; Certifikatë e datës 15.05.2017; Certifikatë e datës 15.05.2017; Certifikatë e datës 11.10.2018; Certifikatë e datës 22.03.2019; Certifikatë e datës 06-12.10.2019; Certifikatë e datës 10.2021; Certifikatë e datës 28.06.2022; Certifikatë e datës 07.2022; Certifikatë e datës 20.09.2011-27.01.2012; Certifikatë e datës 08.09-10.09.2011; Vërtetim i datës 10.01.2003; Certifikatë e datës 06.2011; Fletëkonfirmim 8i për kryerjen e praktikës; Certifikatë e datës 22-23.05.2004; Certifikatë e datës 12-30.07.2004; Certifikatë e datës 11.2004; Certifikatë e datës 11.06.2005; Certifikatë e datës 12-16.07.2004; Certifikatë e datës 06.06.2010; Certifikatë e datës 11.06.2010; Certifikatë e datës 11.07.2010; Certifikatë e datës 04-06.10.2010; Certifikatë e datës 17.10.2010; Certifikatë e datës 26.12.2010; Fletëkonfirmim për kryerjen e praktikës së studentit; Certifikatë e datës 05-06.04.2011; Certifikatë e datës 29.01-01.02.2008; Licence e përkohshme e psikologut me nr. të licencës KO-098-07; Certifikatë e regjistrimit të OJQ nr. 5111872-3 e datës 08.05.2008; Certifikatë e datës 23.06.2005; Referencë me nr. prot. 277/0218 e datës 02.02.2018; Letër reference e datës 03.06.2008; Letër referencë e datës 23.02.2006; Vërtetim nr. 66/08 i datës 07.04.2008; Referencë e datës 24.02.2006; Vërtetim për marrëdhënien e punës nr.67 i datës 05.10.2021; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 31.01.2022, prej 1-3 faqe; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 26.01.2021 prej 1-3 faqe; Cv e A. Mazreku prej 1-3 faqe; Diplomë nga "Kolegji Fama" nr. 4633/0222 e datës 23.02.2022; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" nr. 2993, e datës 06.12.2013; Akt emërim nr. ref.2/ 765 e datës 01.10.2018; Letër konfirmimi i datës 02-06.05.2002; Certifikatë e datës 10.06.2012; Certifikatë nr.891 e datës 17.05.2004; Certifikatë e datës 21.01.2004; Certifikatë e datës 21.12.2016; Certifikatë e datës 22.06.2008; Certifikatë e datës 26.12.2010; Certifikatë e datës 12-13.04.2012; Certifikatë e datës 06.12.2009; Certifikatë e datës 04.10.2009; Certifikatë e datës 15.04.2012; Vërtetim nga QKPP dhe MSH; Fletëkonfirmimi për kryerjen e praktikës Vendim me nr.prot 134 i datës 20.07.2018; Certifikatë Licencimi me numër të licencës 462/18 i datës 17.07.2018; Licencë pune me nr. KO-15722-05-25; Librezë me nr. 000459 e A.M prej 1-3 faqe; Letër rekomandimi i datës 04.04.2019; Letër rekomandimi i datës 10.2022; Vërtetim i marrëdhënies së punës e datës 03.04.2019; Dëshmi me nr.prot 08.2017 e datës 24.01.2017; Letër rekomandimi me nr. 122 e datës 25.01.2017; Vërtetim nr. 32 i datës 03.02.2017; Vërtetim i datës 11.04.2018; Referencë e datës 13.12.2014; Referencë e datës 21.07.2022; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike me nr. ref.238/15 e datës 28.01.2022 prej 1-3 faqe; Formular për vlerësimin e rezultateve në punën provuese me nr.ref.3966/03 e datës 31.12.2020 prej 1-3 faqe; Përgjigje në ankesë e datës 27.09.2022, me numër protokolli 5694/2022, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar ,SEPSE:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Ministria e Mbrojtjes më datë 05.07.2022 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00009334 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Psikolog" ku afati për aplikim ka qenë nga data 21.07.2022 deri më datë 28.07.2022, ndërsa, kriteret formale të konkursit kanë qenë:

- *Diplomë Universitare nga fusha e Psikologjisë, me të paktën 240, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to.*
- *Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sistemin arsimor*

Po ashtu në këtë konkurs është përcaktuar se: *"Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil".*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, ka shqyrtuar tërë ligjshmërinë e këtij procesi dhe në bazë të provave të administruara ka konstatuar që kandidatja e rekomanduar [redacted] ka të kryer Fakultetin Filozofik në Prishtinë- Drejtimi Bachelor i Psikologjisë, dhe ka diplomuar me datë 30.06.2013, Master i Arteve në Psikologji, në Kolegjin Fama, dhe ka diplomuar me datë 02.06.2021, me përvojën e punës si në vijim; nga data 01.10.2018, në Universitetin e Prishtinës, sipas Akt Emërimit në pozitën *"Zyrtare Administrative në Dekanat"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht fushës së zbatimit të paraparë me nenin 2, është përcaktuar se: *"1. Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. 2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës".*

Me nenin 2 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike", si rrjedhojë kandidatja e rekomanduar është e punësuar në Universitetin e*

Prishtinës, e që në kuptim nenin 2 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik, si rrjedhojë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve arsimore kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik dhe nuk hyjnë në kategorinë e nëpunësve civil, kjo ndërlihet me nenin 67 paragrafi 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Duke u bazuar në këtë, si dhe duke u bazuar në kushtin e konkursit se *“Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil”* si dhe duke u bazuar në nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni...”*, dhe nenin 40 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil”*

Nga se u tha me lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kandidatja e përzgjedhur e cila konstatohet që nuk e ka statusin e nëpunësit civil nuk ka pasur të drejtë të aplikoj për lëvizje brenda kategorisë për pozita të nëpunësit civil, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mbrojtjes me rastin e verifikimit para përmes të cilit ka përfshirë në listë të ngushtë këtë kandidatë ka vepruar në kundërshtim me kushtin e konkursit, nenin 38 paragrafi 2 dhe 5 të ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 40 paragrafi 3, nenin 44 paragrafi 2, nenin 45 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht edhe çdo fazë tjetër e procedurës në të cilën ka marr pjesë kandidatja e rekomanduar është zhvilluar si rezultat i shkeljeve procedurale dhe e njëjta procedurë është e paligjshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë i Ministrisë së Mbrojtjes me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Prot:2347 të datës 29.08.2022, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Bazuar në këtë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, është i obliguar që në pajtim me këtë vendim të ndërmerr veprimet e nevojshme që të bëjë zbatimin e këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.m.770/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.